**Data e aplikimit:**
**Kaçanik** 02. 09 **2020.**

**Nënshkrimi i aplikuesit:**

SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUARA, KAÇINKA L.L.C. FERIZAJ

## Regjistrimi i aplikantëve

| Nr. | Nr. Aplikacionit | Data e Pranimit | Emri i Aplikuesit | Statusi i aplikuesit | Adresa/ Komuna/Shteti | Numri i Parcelës | Vendi i Parcelës |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | 01.104/02-22123 | 08.09.2020 | „ANKOS" | SHPK | PRISHTINË | 00401-0, 00402, 403 | Z.K. KAÇANIK I VJETËR |
| 2 | 01.104/02-21626 | 02.09.2020 | „KAÇINKA" | LLC | FERIZAJ | 00402-0, 00403-0 | Z.K. -//- |
| 3 | 01.104/02-21996 | 07.09.2020 | „MECATYPE" KS | SHPK | FERIZAJ | 143-1 | Z.K. DOGANAJ |
| 4 | 01.104/02-22001 | 07.09.2020 | MYNIR GASHI | | KAÇANIK | 02706-3 | Z.K. BEGRACË |
| 5 | 01.104/02-21987 | 07.09.2020 | „COMPANY MURSELI" | SHPK | | 00143-1, 00143-3 | Z.K. DOGANAJ |
| 6 | 01.104/02-20606 | 25.08.2020 | „NDRICIMI GROUP" | SHPK | KAÇANIK | 00143-1, 00143-2, 00143-3 | Z.K. DOGANAJ |
| 7 | ~~01.104/02-22146~~ | ~~08.09.2020~~ | ~~„Idea Invest" & AR INVESTMENTS~~ | ~~SHPK~~ | | | |
| 8 | 01.104/02-22777 | 15.09.2020 | TERZIU GROUP | SHPK | KAÇANIK | 00143-2 | Z.K. DOGANAJ |
| 9 | 01.104/02-22775 | 15.09.2020 | BEKA & TËRZIU SH | NTSH & SHPK | KAÇANIK | 00143-8 | Z.K. DOGANAJ |
| 10 | | | | | | | |
| 11 | | | | | | | |
| 12 | | | | | | | |
| 13 | | | | | | | |
| 14 | | | | | | | |
| 15 | | | | | | | |
| 16 | | | | | | | |
| 17 | | | | | | | |
| 18 | | | | | | | |
| 19 | | | | | | | |
| 20 | | | | | | | |

**Komisioni Vlerësues:**

1.Besnik Bajra-Zyrtar Komunal

2.Zekirja Elezi-OJQ

3.Kadri Krivenjeva-PDK

4.Adnan Reka- LVV

5.Bujar Dullovi-Zyrtar Komunal

REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E KAÇANIKUT • OPŠTINA KAČANIK • MUNICIPALITY OF KAÇANIK

KAÇANIKU

Mbështetur në nenet 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 16, të Ligjin Nr.06/L-092, nenet 1, 2, 4, 5, 13, 14, 15, 17, 19, 20, 21, 22 të Rregullores (QRK) – Nr.09/2020 për përcakti procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, vendimi 01Nr.16-4996/2016, si dhe vendimi për ndryshim plotësimin para të Kuvendit Komunal të Kaçanik për dhënjen e pronës së paluajtëshme të komunës në shfrytëzim afatgjatë, 01Nr.104-2-9777/2017, Komisioni Vlerës ofertave për dhënien e pronës së paluajtshme në shfrytëzim i caktuar me vendim 01.Nr.60/01-36810/19, dhe vendimi për ndryshim plotësimin e vendin Kuvendit të Komunës së Kaçanik, 01.Nr.104/02-3037/20, të dt. 28.02.2020 në mbledhjen e mbajtur me datë 28/08/2020 shpallë këtë:

# NJOFTIM PËR KONKURS PUBLIK

## KONKURS PUBLIK PËR DHËNIE E PRONAVE TË PALUAJTSHME TË KOMUNËS NË SHFRYTËZIM AFATGJATË

**Njoftim publik për dhënie e pronave të paluajtshme në pronësi të Komunës, përmban si në vijim:**

**Afati i dhënies në shfrytëzim të këtyre pronave të paluajtshme të Komunës është afatgjatë prej nëntëdhjetë e nëntë (99) vite.**

- Parcelat Kadastrale nr. P-70917026-00143-1, ne sipërfaqe të përgjithshme **18.777**m$^2$ P.SH. KK Kaçanik, me kulturë kullosë e klasës 4, **"Fusha e Mulës"** që gjendet në-Zonën Kadastrale **Doganaj – Kaçanik.**
- Parcelat Kadastrale nr. P-70917026-00143-2, ne sipërfaqe të përgjithshme **15.001**m$^2$ P.SH. KK Kaçanik, me kulturë kullosë e klasës 4, **"Fusha e Mulës"** që gjendet në-Zonën Kadastrale **Doganaj – Kaçanik.**
- Parcelat Kadastrale nr. P-70917026-00143-3, ne sipërfaqe te përgjithshme **14.995**m$^2$ P.SH. KK Kaçanik, me kulturë kullosë e klasës 4, **"Fusha e Mulës"** që gjendet në-Zonën Kadastrale **Doganaj – Kaçanik.**
- Parcelat Kadastrale nr. P-70917003-02706-3, ne sipërfaqe te përgjithshme **20.905** m$^2$, P.SH. KK Kaçanik, me kulturë kullosë e klasës 3, " Mahalla Trenaj", **"Fusha e Madhe"** që gjendet në-Zonën Kadastrale **Begracë – Kaçanik.**
- Parcelat Kadastrale nr. P-70917086-00401-0, ne sipërfaqe te përgjithshme **34.594** m$^2$, P.SH. KK Kaçanik, me kulturë kullosë e klasës 4, "Gllavica", që gjendet në-Zonën Kadastrale **Kaçanik i Vjetër – Kaçanik**

**Afati i dhënies në shfrytëzim të këtyre pronave të paluajtshme të Komunës është afatgjatë prej katërdhjetë (40) vite.**

- Parcelat Kadastrale nr. P-70917003-01580-0, ne sipërfaqe te përgjithshme **23.379** $m^2$. P.SH. KK Kaçanik, me kulturë kullosë e klasës 3, "Mahalla Trenaj", **"Fusha e Madhe"** që gjendet në-Zonën Kadastrale **Begracë – Kaçanik.**
- Parcelat Kadastrale nr. P-70917003-01579-0, ne sipërfaqe te përgjithshme **6480** $m^2$. P.SH. KK Kaçanik, me kulturë kullosë e klasës 3,"Gllavica", **"Fusha e Madhe"** që gjendet në-Zonën Kadastrale **Begracë – Kaçanik.**
- Parcelat Kadastrale nr. P-70917086-00402-0, ne sipërfaqe te përgjithshme **9548** $m^2$. P.SH. KK Kaçanik, me kulturë kullosë e klasës 4, "Gllavica", që gjendet në-Zonën Kadastrale **Kaçanik i Vjetër – Kaçanik.**
- Parcelat Kadastrale nr. P-70917086-00403-0, ne sipërfaqe te përgjithshme **3299** $m^2$. P.SH. KK Kaçanik, me kulturë kullosë e klasës 3, "Gllavica - **Mahalla e Përzhve**" që gjendet në-Zonën Kadastrale **Kaçanik i Vjetër – Kaçanik.**

**Veprimtaria që ushtrohet sipas destinimit të pronës:**

- **Parcelat** të theksuara më lartë janë të destinuara për **Zhvillim Ekonomik** – zona industriale me (PZHK) Vendim të Kuvendit të Komunës.

**Zgjedhja e ofertës për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës, bazohet në kriteret vijuese:**

- Oferta ekonomikisht më e favorshme që përfshinë:
- Vlera e investimit;
- Numri i të punësuarve nga investimi;
- Lloji i investimit që është me interes publik me prioritet për komunën;
- Plani dinamik i punës;

**Të drejtat dhe përgjegjësitë e pjesëmarrësve në konkurs publik;**

- Të drejtë pjesëmarrje dhe konkurrimi, kanë të gjithë personat fizik dhe juridik të Republikës së Kosovës.
- Komisioni vlerësues, pas përfundimit të afatit për shqyrtimin e ankesave për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës e procedon në Kuvendin e Komunës për aprovim ofertën e përzgjedhur nga komisioni.Specifikat tjera do të bëhen me marrveshje;.
- Për zbatimin e vendimit të Kuvendit të Komunës, obligohet Kryetari i Komunës të nënshkruan kontratë me fituesin, me anë të së cilës përcaktohen të drejtat dhe obligimet e palëve kontraktuese.
- Pala e pakënaqur me vlerësimin e komisionit, ka të drejtë të parashtrojë ankesë pranë komisionit për vlerësimin e ankesave në afatë prej shtatë (7 ) ditësh.

**Kushtet apo kufizimet mbi dhënien e të drejtave në shfrytëzim :**

- Prona nuk mund të përdoret për qëllime tjera. vetëm siç është përcaktuar me konkurs publik dhe i njëjti nuk mund të bartet në shfrytëzim te personat e tr

**Kohëzgjatja e shpalljes së konkurimit publik dhe data e fundit e dorëzimit të ofertave:**

- Kohëzgjatja e shpalljes së konkurimit publik për dhënien e pronave për shfrytëzim afatgjatë është **pesëmbëdhjetë (15) ditë** nga dita e publikimit në uet faqen e Komunës. në vendet publike, elektronike dhe të shkruara.
- Dokumentacioni për ofertim tërhiqet në Qendrën për shërbim ndaj qytetarëve (kati përdhesë nr. 5) nga **data 01.09.2020 deri me date; 15.09.2020** në ora **15:00,** dorëzimi i aplikacioneve bëhet në Qendrën për shërbim ndaj qytetarëve, çdo ditë pune prej orës **08:00** deri **16:00.**

**Vendi, koha ku do të mbahet konkursi publik:**

- Në sallën e Kuvendit Komunal, me dt.**16.09.2020** me fillim nga ora: **15:00**. do të bëhet hapja e ofertave të mbyllura dhe të njëjtat do **të** bëhen publike gja hapjes, duke siguruar qasje të drejtpërdrejtë për pjesëmarrësit në konkurs publik.

**Vërejtje:**

. Të interesuarit mund të informohen (çdo ditë pune ) përmes
-Ueb faqës –http//kk-rks-gov.net/kacanik/
-Te.038-200 46-423
-Email Besnik.Bajra @rks-gov.net

**Kaçanik 01.09.2020**

**Komisioni vlerësues i Ofertave**
Kryesues z.Besnik Bajra

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

KAÇANIKU

Komuna Kaçanik
Skupština Opština
Municipality of Kaçanik

REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E KAÇANIKUT
OPŠTINA KAČANIK
Data 15.02.016 Vendi Kaçanik
Nr. reg. | Numri | Shifra
01 Nr. 16-4996/2016

Në bazë të nenit 14 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr. 28/ 2008), të nenit 3 pika 1 paragrafi 4 lidhur me nenet. 4,6 dhe 7.3 paragrafi 1. i Ligjit Nr.04/L-144, Për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr. 35/17,dhjetor 2012), të nenit 5 të Rregullores QRK 23/2013- Për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfytëzim dhe këmbimit të pronës së paluajtshme të Komunës, të nenit 3 të Statutit të Komunës, të Propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës prej dates 08.02.2016, Kuvendi i Komunës Kaçanik, në mbledhjen e vet të mbajtur me datë. 15.02.2016, merr këtë:

**VENDIM**
**PARAPRAK PËR DHËNIEN E PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS NË SHFYTËZIM AFATGJATË**

1. Me këtë Vendim ipen në shfrytëzim **AFATGJATË**, pronat e paluajtshme të Komunës së Kaçanikut, personave fizik dhe juridik.

2. Pronat e palujtshme për dhënie në shfrytëzim të cekur si në pikën 1 të këtij Vendimi ipen në shfrytëzim në periudhë afatgjatë kohore, për **katërdhjetë (40) vite**, në Zonat Kadastrale si vijon:

2.1. Zona Kadastrale Begracë :

2.1.1. Ngastra kadastrale nr. 02706-0 me S=03.93.64 ha,
2.1.2. Ngastar kadastrale nr. 02647-0, me S=00.27.64 ha,
2.1.3. Ngastra kadastrale nr. 01580-0 me S=02.33.79 ha,
2.1.4. Ngastra kadastrale nr. 01579-0 me S=00.64.80 ha.

2.2. Zona kadastrale Doganaj :

2.2.1. Ngastra kadastrale nr. 00143-0 me S=04.94.90 ha,
2.2.2. Ngastra kadastrale nr. 00124-0 me S=00.46.01 ha.

2.3. Zona Kadastrale Gërlicë e Epërme :

2.3.1. Ngastra kadastrale nr. 00215-0 me S=00.28.57 ha,
2.3.2. Ngastra kadastrale nr.00217-0, me S=00.94.13 ha

2.4. Zona kadastrale Kaçanik i Vjetër :

[redacted]

2.4.2. Ngastra kadastrale nr. 01405-0 me S=00.66.28 ha,

[redacted]

2.4.4. Ngastra kadastrale nr. 00402-0 me S=00.95.48 ha,

2.4.5. Ngastra kadastrale nr. 00403-0 me S=00.32.99 ha

3. Pronat e përcaktuara në ngastrat kadastrale të pikës 2. të këtij Vendimi, janë pronë e Komunës Kaçanik.

4. Qëllimi i dhënies në shfrytëzim të pronës komunale është: krijimi i kushteve për zhvillim të bizneseve, krijimi i mundësisë për investime nga investitorë vendor dhe të huaj, me ç'rast do të krijohen vende të reja të punës.

5. Me dhënien e pronës komunale në shfrytëzim sipas dispozitave ligjore në fuqi, komuna do të mund të inkason edhe të hyra komunale të cilat do të konsiderohen para publike dhe i nënshtrohen dispozitave ligjore për menaxhimin e financave publike.

6. Procedura për dhënien e pronës së paluitshme të Komunës në shfrytëzim në periudhë afatgjatë do të bëhet përmes. Konkursit të hapur Publik.

6.1. Procedurat e parapara me Ligjin Nr.04/L-144, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së palujtshme të Komunës. dhe me Rregulloren e QRK 23/2013- Për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfytëzim dhe këmbimit të pronës së palujtshme të Komunës do t'i zhvilloi. Komisioni vlerësues për dhënien në shfrytëzim pronën e paluajtshme të komunës. i formuar me Vendim të Kuvendit të Komunës.

7. Për realizimin e këtij Vendimi do të kujdeset. Kryetari i Komunës.

8. Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokolit të autoritetit mbikqyrës-MAPL, si dhe pas publikimit në faqen zyrtare të komunës.

**Vendimi iu dërgohet:** MAPL, Komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronave të paluajtshme të komunës, Kryetarit të Komunës, DUKMM, dhe Arkivit.

Kryesuesi i Kuvendit,

Xhelal Çashi

# PROCESVERBAL

1. KOMISIONI PËR DHËNIEN E PRONËS KOMUNALE NË SHFRYTËZIM
VLERËSIMI I OFERTAVE

**filloi** 14:25

**Data:** 23.09.2020

- Kryesuesi i komisionit z. Besnik Bajra përshëndeti dhe falënderoi anëtarët e komisionit për prezencën dhe punën e tyre, gjatë vlerësimit të ofertave për dhënien e pronës komunale në shfrytëzim.

- Ofertuesit për parcelën 143-1 z.k. DOGANAJ, për këtë parcelë kemi tre ofertues:
  1. MECATYPE
  2. NDRIQIMI GROUP
  3. MURSELI COMPANY

- Kriteri i parë: Dokumentacioni
Sa i përket çështjes së dokumentacionit të ofertuesve „NDRIQIM GROUP" është i kompletuar, „MECATYPE-KS" i mungon referenca dhe plani dinamik i punës, „MURSELI COMPANY" i mungon dëshmia për obligimet komunale (jo valide) dhe plani dinamik i punës.

- Kriteri i dytë: Vlera e investimit
  1. MECATYPE KS — vlera e investimit 3.700.000 €
  2. MURSELI COMPANY — vlera e investimit 2.205.000 €
  3. NDRIQIMI GROUP — vlera e investimit 11.000.000 €

- Kriteri i tretë: nr. i të të punësuarve

| Aktual | | të propozuara? |
|---|---|---|
| 1. MECATYPE | 20 | 70 |
| 2. MURSELI COMPANY | 16 | 217 |
| 3. NDRIGIMI GROUP | 20 | 230 |

Mbyllja e takimit bëhet në ora 17:20

Komisioni:

1.Besnik Bajra ____________

2.Adnan Reka ____________

3.Zekirja Elezi____________

4.Kadri Krivenjeva____________

5.Bujar Dullovi____________

PROCESVERBAL 28.09.2020

Fillon: 14:00

Të pranishëm:

1. Besnik Bajra
2. Kadri Krivanjeva
3. Adnan Reka
4. Bujar Dullovi
5. Zubije Elezi

Komisioni për dhënien e pronës komunale në shfrytëzim, parcela 143-2 Z. K. DOGANAJ

Për këtë parcelë kanë ofertuar dy kompani:

1. NDRIQIMI GROUP, i kompletuar
2. JËRZIU SHPK.

- Punëtorët aktual 1 punëtorët e propozuar 70
- Vlera e investimit 1.300.000€

Parcela 143-3 Z. K DOGANAJ

1. NDRIQIMI GROUP
2. BEKA & JËRZIU SHPK
3. MURSELI COMPANY

- Adnan Reka - unë mendoj se duhet të shkojmë në përkomërë me dokumentacionin dhe kriteret aktuale, duhet të anulohet procesi dhe konkursi duhet të kompletohet me kritere shtesë.

- Kadri Krivanjeva - unë pajtohem me mendimin e kolegut Adnan Reka, se ky proces të shqyrtohet në bazë të dokumentacionit aktual apo procesi të anulohet dhe konkursi të kompletohet me kritere shtesë.

- Besnik Bajra - kryesues i komisionit pajtohet me propozimin e anëtarëve, që konkursi të anulohet. Për shkak të vlerës së madhe të investimeve dhe ndjeshmërisë së procesit, konkursi duhet të bëtë kritere shtesë me të cilat do të njoftohen ofertuesit në konkursin e ardhshëm (pasqyra financiare e ATK-së, rrjedhshmëria bankare, garancion bankar,) Lista e punëtorëve të regjistruar në ATK.

- Bujar Dullovi - pajtohem me mendimin e kolegëve që procesi të anulohet dhe në konkursin e ardhshëm konkursi të plotësohet me kritere shtesë.

- Zekirja Elezi - unë mendoj që konkursi nuk duhet të përsëritet për shkak se kemi aplikues sërish që me investimet e tyre do të ndikonin drejtpërdrejt në zhvillimin ekonomik të Komunës.

Nëse kemi nevojë për informacione shtesë, mendoj se kemi të drejt të kërkojmë nga aplikuesit.

Nga konkurenca e krijuar në këtë konkurs, mendoj që parcela 143-1 është mirë të ndahet me qëllim që të krijojë për interesin komunal.

01.10.2020

Takimi përfundoi më të endjen në ora 14:30

1. ADNAN REKA - [signature]
2. ZEKIRIJA ELEZI - [signature]
3. KADRI KRIVANJEVA - [signature]
4. BESNIK BAJRA - [signature]
5. BUJAR DULLOVI - [signature]

**PROCESVERBAL I KOMISIONIT VLERËSUES**

1. Vlerësimi i dokumentacionit të operatorëve ekonomik

filloi 14:30
Data: 01.10.2020

- Vlerësimi i dokumentacionit të operatorëve ekonomik për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale.
Dhënia në shfrytëzim e parcelave 401-0, 402-0, 403-0 z.k. Kaçanik i Vjetër.

- „KAÇINKA" LLC ka ofertuar për parcelat 402-0, 403-0 të Z.K. Kaçanik i Vjetër, këto dy parcela do të jepen në shfrytëzim për 40 vjet.

- „ANKOS" SHPK ka ofertuar për parcelat 401-0, 402-0, 403-0 në Z.K. Kaçanik i Vjetër, parcela 401-0 do të jepet në shfrytëzim për 99 vjet kurse parcelat 402-0, 403-0, do të jepen në shfrytëzim për 40 vjet.

401-0 ka sipërfaqe 3.4594 ha, me kulturë kullosë e kl. 3
402-0 ka sipërfaqe 95.48 ari, me kulturë kullosë e kl. 3
403-0 ka sipërfaqe 32.99 ari, me kulturë kullosë e kl. 3

- Mynir Gashi - person fizik ka ofertuar për parcelën 2706-3 Z.K. Begracë.

Zobija Elezi - duke u bazuar në mbledhjen e kaluar ngjedhën propozimet që të analizohet më detale vepimet e mëtejshme. Unë mora obligimin që të kontaktojë

juristë dhe komisione të komunave të tjera që të shfrytëzojmë përvojat e tyre rreth kësaj çështje. Dhe tani kam përforcuar bindjen që ne të vazhdojmë me punë duke i ftu aplikuesit në intervistim dhe të sjellin dokumentacionin shtesë të cilin komisioni mendon që është i nevojshëm.

- Adnan Reka - duke pasur parasysh konkursin publik dhe kriteret e atij konkursi, unë mendoj se komisioni duhet të bazohet në dokumentacionin dhe kriteret e ofertuesëve, ~~të~~ për të qenë sa më korrekt në raport me ofertuesit. Çdo dokument apo kërkesë shtesë mendoj se i bën të pabarabartë ofertuesit.
- Kadri Krivanjeva pajtohem me propozimin e kolegut Zekirja Elezi, që komisioni të ftojë në intervistë ofertuesit dhe të kërkojë dokumentacione shtesë
- ~~Pajtoh~~ Besnik Bajra pajtohem me propozimin e kolegut Zekirja Elezi dhe Kadri Krivanjevës.

- Bujar Dullovi, i qëndrojë pas mendimit të mbledhjes së kaluar, që komisioni të vlerësojë ofertuesit në bazë të dokumentacionit të prezantuar apo të anulojë procesin.

Mbyllja e takimit bëhet në ora 16:20

**Komisioni:**

1.Besnik Bajra ______

2.Adnan Reka ______

3.Zekirja Elezi ______

4.Kadri Krivenjeva ______

5.Bujar Dullovi ______

(1.)

30.10.2020

Komisioni për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale

Takimi i komisionit filloi në ora 14:30,

Komisioni rekomandon që parcelat:
Parcelat 402-0 me sipërfaqe 9548 m² dhe parcelën 403-0 me sipërfaqe 3299 m² në Zonën Kadastrale, Kaçanik i Vjetër të cilat do t'i japen në Shfrytëzim për 40 vite kemi dy ofertues:

1. KAÇINKA LLC dhe
2. ANKOS SHPK

- Komisioni rekomandon që këto parcela që kanë sipërfaqe prej 1.28.47 ha t'i japen në shfrytëzim për 40 vite ofertuesit KAÇINKA LLC.

- Për parcelën 401-0 me sipërfaqe 3.45.94 ha Z.K. Kaçanik i Vjetër kemi vetëm një ofertues „ANKOS" SHPK. Komisioni rekomandon që kjo parcelë t'i jepet në shfrytëzim për 99 vite, ofertuesit „ANKOS" SHPK. Po ashtu komisioni kërkon sqarim ~~se rekomandimi~~ nga zyra ligjore e komunës dhe MAPL se rekomandimi për këtë ofertues

(2.) a është në përputhje me ligjin për Investime Strategjike nr. 05/L-079.

- Për parcelën 2706-3 Z.K. Begracë kemi një ofertues person fizik Myzafer Gashi. Komisioni rekomandon që kjo parcelë me PZHK- është e destinuar për zonë industriale dhe nuk përputhet me kërkesën me të cilën ka ofertuar ofertuesi i lartëshënuar.

- Komisioni rekomandon që kjo parcelë të ruhet për investitorë tjetër konform destinimit të saj me plane komunale.

- Për parcelën 143-1 me sipërfaqe 18.777 m² Z.K. Doganaj komisioni rekomandon që kjo parcelë të ndahet në dy pjesë të barabarta, (vija ndarëse) që kufiri të jetë lindje-perëndim. dhe atë pjesa veriore t'i ndahet ofertuesit MECATYPE KS kurse pjesa jugore MURSELIT COMPANY. Arsyeja e një ndarje të tillë për shkak të ngjashmërisë të veprimtarive e ofertuesve. Për arsye se kemi dy ofertues serioz, komisioni u përcaktua për ndarjen e kësaj parcele në dy pjesë. Ofertuesi MURSELI COMPANY ka ofertuar për ndarjen e

(3.) fabrikës së tekstilit me vlerë të investimit 2.205.000€ dhe me 217 punëtorë. Ndërsa MECATYPE KS ka ofertuar për hapjen e fabrikës së prodhimit të pajisjeve të mekanikës precize, prodhim i cili është i tëri për export, me vlerë të investimit 3.700.000€ dhe me numër të punëtorëve nga 20 aktual dhe 70 të tjerë.

- Për parcelën 143-3 me sipërfaqe 14.995 m² Z.K. Doganaj komisioni rekomandon që t'i jepet në shfrytëzim ofertuesit NDRIQIMI GROUP. Parcela i ndahet me qëllim të ushtrimit të veprimtarisë për prodhimin e plastikës.

- Për parcelën 143-2 me sipërfaqe 15.001 m² Z.K. Doganaj ~~[illegible]~~ ofertuesi NDRIQIMI GROUP i plotëson kriteret për marrjen në shfrytëzim të kësaj parcele, mirëpo në intervistën 13.10.2020 ~~ofertuesi~~ pronari i NDRIQIMI GROUP NEHAT VOGLIQI ka deklaruar se nuk ka interesim për këtë parcelë.

- Kjo parcelë mbetet e lirë - nuk jepet në shfrytëzim pasiqë edhe ofertuesi i dytë TËZRJU GROUP SHPK nuk i plotëson kriteret e kërkuara me konkurs publik.

1.

2.

3.

4.

5.

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova**
**Republic of Kosovo**

**Komuna e Kaçanikut**
**Opština Kacanik**
**Municipal Kacanik**

**01Nr. 104/02-1520/21**
**Kaçanik, 29.01.2021**

Në mbështetje të nenit 12 të Ligjit nr. 03/L-040-për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare Nr. 28/04 Qershor 2008), të nenit 18 paragrafi 3 të Ligjit Nr.06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës(Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.10/03 Prill 2019, sipas Propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës 01Nr.104/02-1520/21, Kuvendi i Komunës Kaçanik që në mbledhjen e mbajtur me 29 Janar 2021, mori këtë:

**VENDIM**
**PËR PLOTËSIM NDRYSHIMIN E VENDIMIT TË KK 01 NR. 104/02-18863/19 TË DATËS 28.06.2019 DHE VENDIMIT 01Nr.104/02-20723/20 TË DATËS 08.09.2020- PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR SHQYRTIMIN E ANKESAVE TË PALËVE NË PROCEDURËN E DHËNIES NË SHFRYTËZIM TË PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS**

**1.** Me këtë Vendim, Ndryshohet dhe Plotësohet Vendimi i Kuvendit Komunal 01NR.104/02-18863/19 të datës 28.06.2019 përkatësisht Vendimi 01Nr.104/02-20723/20 të datës 08.09.2020 për formimin e Komisionit për shqyrtimin e ankesave të palëve në procedurën e dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës.

**2.** Ndryshim Plotësimet e Vendimeve të Kuvendit të Komunës të përcaktuar si në pikën 1 të këtij vendimi, bëhet në çdo pikë dhe paragraf të vendimeve ku janë të shënuar emrat e anëtarëve: Milazim Salijaj, dhe Zekeria Koxha.

2.1 Anëtari i komisionit, Milazim Salijaj ka dhënë dorëheqje nga ky komision, në vend të tij, caktohet për anëtar, **Ardiana Tusha** nga OJQ/ shoqëria civile.

2.2 Në vend të anëtarit tjetër të lartë cekur, për anëtar të komisionit nga Ekzekutivi i Komunës, caktohet, **Ibush Lika**.

**3.** Me Ndryshim plotësimet e bëra me këtë Vendim, Komisionit për shqyrtimin e ankesave të palëve në procedurën e dhënies së pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim ka këtë përbërje:

3.1. Vlora Dalloshi, anëtare e KK nga PDK;
3.2. Agim Mani, anëtar i KK nga LVV;
3.3. Ibush Lika , anëtar nga Ekzekutivi i Komunës;
3.4. Edmond Mjaku, anëtar nga Ekzekutivi i Komunës dhe
3.5. Ardiana Tusha, anëtare nga shoqëria civile .

**4**. Pikat tjera të Vendimit mbesin të pandryshuara.

**5.**. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen: Kryetari i Komunës, Drejtoria e Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit dhe Drejtoria e Ekonomisë, Financave dhe Zhvillimit.

**6.**Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës – MPL si dhe pas publikimit në faqen zyrtare të komunës.

**Vendimi u dërgohet:** Kryetarit të Komunës, Drejtorisë së Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, Drejtorisë së Ekonomisë, Financave dhe Zhvillimit dhe Arkivi.

**Kryesuesi i Kuvendit**
**Kemal Mërseli**

DALJE-IZLAZNA-OUTGOING
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministry of Local Government Administration
Nr. 020-783/11 -VI-
Datë 18.02.2021

# Republika e Kosovës
## Republika Kosova-Republic of Kosovo
## Qeveria - Vlada – Government
*Ministria e Pushtetit Lokal*
*Ministarstvo Lokalne Samouprave*
*Ministry of Local Government*

| | | |
|---|---|---|
| Për: | **Besim Ilazi**, Kryetar i Komunës së Kaçanikut<br>**Kemal Mërseli**, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Kaçanikut | |
| Kopje: | Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në MPL<br>Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në Komunë | |
| Përmes: | **Goran Rakić** Zëvendës Kryeministër dhe Ministër i MPL-së<br>**Trim Berisha**,Zv. Sekretar Përgjithshëm i MPL-së | |
| Nga: | **Venera Çerkini**, Udhëheqëse e Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave | Datë: 15.02.2021 VI-020-783/10 |
| Zyrtaret përgjegjës:<br>1. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor<br>2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor | **Xhevat Tafa**, Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave<br>**Gëzim Sahiti**, Zyrtar i lartë për monitorim të komunave | |
| Lënda: | Konfirmim i ligjshmërisë së aktit të Komunës së Kaçanikut | |
| Lloji i aktit: | □ Vendim i Kuvendit të Komunës | |

I nderuar Kryetar,
I nderuar Kryesues,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 06/2020 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

| |
|---|
| Vendim i Kuvendit të Komunës 01 Nr.104/02-1520/21 për plotësim ndryshimin e vendimit të KK 01 Nr.104/02-18863/19 të datës 28.06.2019 dhe vendimit 01 Nr.104/02-20723/20 të datës 08.09.2020 për formimin e komisionit për shqyrtimin e ankesave të palëve në procedurën e dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës. |
| I miratuar më datë: 28.01.2021 |
| I parashtruar për shqyrtim në MPL më datë: 05.02.2021 |

Ministria e Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës në aspektin procedural <u>është në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi</u>. Ministria e Pushtetit Lokal mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejmë në lidhje me këtë vlerësim.

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova**
**Republic of Kosovo**

**Komuna e Kaçanikut**
**Opština Kacanik**
**Municipal Kacanik**
**01Nr. 104/02-20723/20**
**Kaçanik, 08.09.2020**

Në mbështetje të nenit 12 të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/04 Qershor 2008) të nenit të Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.10/03 Prill 2019, duke vendosu sipas Propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës 01Nr. 104/02-20723/20, Kuvendi i Komunës Kaçanik, në mbledhjen e në mbledhjen e mbajtur me 08 Shtator 2020, mori këtë:

**VENDIM**
**PËR NDRYSHIM PLOTËSIMIN E VENDIMIT TË KUVENDIT TË KOMUNËS 01 NR. 01NR.18863/19 TË DATËS 28.06.2019 PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR SHQYRTIMIN E ANKESAVE TË PALËVE NË PROCEDURËN E DHËNIES SË PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS NË SHFRYTËZIM**

**1.** Me këtë Vendim, Ndryshohet dhe Plotësohet Vendimi i Kuvendit Komunal 01 Nr. 18863/19 të datës 28.06.2019- Për formimin e Komisionit për shqyrtimin e ankesave të palëve në procedurën e dhënies së pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim.

**2.** Ndryshim Plotësimet e Vendimit të Kuvendit të Komunës të përcaktuar si në pikën 1 të këtij vendimi, bëhet te paragrafi 1.2 i pikës 1 të vendimit, ashtu që:

2.1 Nga komisioni i ankesave hiqet, Shpend Krusha, ish anëtar i KK nga Lëvizjes Vetëvendosje i cili ka dhënë dorëheqje nga pozita e anëtarët të kuvendit, e që nënkupton se ai lirohet nga të gjitha përgjegjësitë e tij të cilat i kishte si dhe lirohet po ashtu edhe nga të gjitha komisionet në të cilat ishte anëtar.

2.2 Në vend të anëtarit të hequr caktohet për anëtar të komisionit, Agim Mani, anëtar i KK nga Lëvizja Vetëvendosje.

**3.** Me ndryshimet të cilat janë bërë, Komisioni i Ankesave ka këtë përbërje:
1.1. Vlora Dalloshi, anëtare e KK nga PDK;
**1.2. Agim Mani, anëtar i KK nga LVV;**
1.3. Zekeria Koxha, anëtar nga Ekzekutivi i Komunës;
1.4. Edmond Mjaku, anëtar nga Ekzekutivi i Komunës;
1.5. Milazim Salijaj, anëtar nga shoqëria civile (gjeometër).

**4.** Pikat tjera të Vendimit mbesin të pandryshuara.
**5.** Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen: Kryetari i Komunës, Drejtoria e Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit si dhe Drejtoria e Ekonomisë, Financave dhe Zhvillimit.
**6.** Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës- MAPL, si dhe pas publikimit në faqen zyrtare të komunës.

**Vendimi u dërgohet:**
Kryetarit të Komunës, Anëtarëve të Komisionit, Drejtorisë së Urbanizëm Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtorisë së Ekonomisë, Financave dhe Zhvillimit, dhe Arkivit.

**Kryesuesi i Kuvendit**
**Kemal Mërseli**

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova**
**Republic of Kosovo**

**Komuna e Kaçanikut**
**Opština Kacanik**
**Municipal Kacanik**

**01Nr. 104/02-18863/19**
**Kaçanik, 28. 06.2019**

Në mbështetje të nenit 12 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenit 18 të Ligjit Nr. 06/L-092 -Për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës (Gazeta Zyrtare Nr. 10/ 03 Prill 2019), Kuvendi i Komunës Kaçanik, në mbledhjen e mbajtur me 28 Qershor 2019, mori këtë:

**VENDIM**
**PËR FORMIMIN E KOMISIONIT TË ANKESAVE, PËR SHQYRTIMIN E ANKESAVE TË PALËVE NË PROCEDURËN E DHËNIES NË SHFRYTËZIM AFATSHKURTËR DHE AFATGJATË TË PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS**

1. Me këtë Vendim, formohet Komisioni i Ankesave, për shqyrtimin e ankesave të palëve në procedurën e dhënies në shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës, në përbërje prej 5 (Pesë) anëtarëve, si vijon:
   1.1. Vlora Dalloshi, anëtare e KK nga PDK-së
   1.2. Shpend Krusha, anëtar i KK, nga LVV,
   1.3. Zekeria Koxha, anëtar nga ekzekutivi i komunës,
   1.4. Mentor Shehu, anëtar nga ekzekutivi i komunës, dhe
   1.5. Milazim Salijaj, anëtar nga shoqëria civile (gjeometër).

2. Kryetari i Komisionit zgjidhet nga radhët e anëtarëve nga pika 1 e këtij Vendimi.

3. Detyra dhe Përgjegjësia e Komisionit të ankesave është, pranimi i ankesave të paraqitura në vlerësimin e ofertave për dhënien e pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë dhe shqyrtimi i tyre.

4. Administrata e komunës i ofron përkrahje komisionit të ankesave sipas kërkesave të tyre.
5. Komisioni për ankesa në Komunë bënë shqyrtimin e ankesave brenda dhjetë (10) ditëve kalendarike.
6. Palët e pakënaqura me vendimin e komisionit të ankesave, brenda afatit ligjor mund të iniciojnë kontest administrative.

7. Mandati i komisionit të ankesave është dy (2) vjeçar brenda mandatit të Kuvendit të Komunës.
8. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset, Kryetari i Komunës dhe Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit.

9. Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës- MAPL, si dhe pas publikimit në faqen zyrtare të komunës.

**Me këtë Vendim njoftohen:** Anëtarët e komisionit, Kryetari i Komunës, Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtje të Mjedisit dhe Arkivi.

**Kryesuesi i Kuvendit**
**Kemal Mërseli**

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E KAÇANIKUT
OPŠTINA KAČANIK

| I | Data 14.01.21 | Vendi Kaçanik |
|---|---|---|
| Nj. org. | Numri | Shtojcë |
| 01-104/02- | 1518/21 | |

FOJK

Forumi i OJQ-ve të Kaçanikut

Për: Kryetarin e Komunës së Kaçanikut, z. Besim Ilazi

Nga: Kryetari i Forumit të OJQ-ve të Kaçanikut, Kjani Sallahu

Lënda: KONFIRMIM PËR PËRFAQËSIMIN E SHOQËRISË CIVILE

Me anë të kësaj shkrese i përgjigjemi kërkesës së institucionit tuaj të sipërpërmendur, për përfaqësimin e shoqërisë civile në Komisionin e ankesave për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale të Kaçanikut.

Ju konfirmojmë se përfaqësuese e shoqërisë civile në Kaçanik, në Komisionin e ankesave për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale të Kaçanikut, është caktuar znj. Ardiana Tusha, anëtare e Forumit të OJQ-ve të Kaçanikut, njëherësh kryetare e Këshillit të Veprimit Rinor Lokal, me nr. personal 1244019117, me vendbanim në rr. "Ismail Raka" – Kaçanik.

Kaçanik,
14.01.2021

FORUMI I ORGANIZATAVE JOQEVERITARE TË KAÇANIKUT * NON-GOVERNMENTAL ORGANIZATIONS FORUM * FOJK

Kjani Sallahu

Kryetar i FOJK-ut